



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI BASHKIAK
GRAMSH

Nr. 4306 prot.

Gramsh, më 28/11 /2022

VENDIM

Nr. 81 Datë. 31.10.2022

PËR NXJERRJEN JASHTË PËRDORIMIT TË MATERIALEVE TË ZYRAVE TË BASHKISË DHE INSTITUCIONEVE VARTËSE TË SAJ .

Këshilli i Bashkisë Gramsh, në mbledhjen e tij të datës 31/10/2022, pasi mori në shqyrtim P/Vendimin e paraqitur nga Kryetari i Bashkisë “Për nxjerrjen jashtë përdorimit të materiale të zyrave të bashkisë dhe institucione vartëse të saj”, mbështetur në ligjin Nr.9936 dt.26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, në ligjin Nr 10296, dt 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, nëni 12, gërma f, në ligjin Nr.68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, në Udhëzimit e Ministrisë së Financave dhe ekonomisë Nr .30 dt 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik “ Kreu IV i tij dhe në ligjin Nr. 139/2015 dt 17.12.2015 “Per vetëqeverisjen vendore ,neni 8 ,pika2, neni 9 pika 1.1(b),neni 64 (a).

VENDOSI :

I-Të miratoj nxjerrjen jashtë përdorimit të materialeve të zyrave të bashkisë dhe institucioneve Vartëse të saj si më poshtë:

Llogaria 327 (Inventari i imët)	4,314,103 lekë
Llogaria 214 (makineri e Paisje)	462,075 lekë
Llogaria 218 (inventare ekonomike ,mjete kryesore)	10,191,140 lekë .
Totali i llogarive	14,967,318 (katërbëdhjetë milion e nëntëqind e gjashtëdhjet e shtatë mije e treqind e tetëmbëdhjetë) lekë.

II-Lista e materialeve që do të nxirren jashtë përdorimit është e pasqyruar bashkëlidhur këtij vendimi sipas emërimit, njësisë matëse, cmimit, sasisë, vlerës dhe arsyes së daljes jashtë përdorimit për çdo material.

III-Materialet e nxjerra jashtë përdorimit nga komisioni përkatës, të asgjësohen nga komisioni i ngritur me urdhër të kryetarit.

IV-Vlerat materialet e përcaktuara jashtë përdorimit e që do të asgjësohen nga komisioni me specialiste përkatës, të zbriten nga vlera e inventarit dhe të shkarkohen në kartelat e magazines përkatëse dhe të bëhen hyrje për vlerë të mbetur për ato material që komisioni I gjykon të arsyeshme.

V-Për ndjekjen dhe zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria e Buxhetit dhe Finances.

VI-Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes së tij .

Sekretari i Këshillit Bashkiak
Xhulia GJINI

Kryetari I Këshillit Bashkiak
Greta LENA

Konceptoi: Xh.Gjini
Pranoi: _____
Miratoi: G.Lena
Konfirmoi: _____
Dosja nr: _____
Afati i ruajtjes: _____

